



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

RAPORT INDIVIDUAL PËR KONSULTIMIT PUBLIK
PËR PROJEKTAKTIN

Projektvendim “Për miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për gruan, paqen dhe sigurinë 2023-2027, në Republikën e Shqipërisë"

1. Titulli i Projektaktit:

“Për miratimin e Planit të veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan, paqen dhe sigurinë” 2023-2027 në Republikën e Shqipërisë”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi për Projektvendimin “Për miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për gruan, paqen dhe sigurinë 2023-2027, në Republikën e Shqipërisë” ka zgjatur nga data 18.05.2023 – 15.06.2023 (periudha që dokumenti ka qenë i publikuar në RENJKP).

Konsultime janë zhvilluar edhe përmes takimeve online dhe tryezave konsultative në MSHMS.

3. Metoda e konsultimit:

Metodat e konsultimit të përdorura për këtë projektakt janë takimet online, tryezat konsultative dhe publikimi në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimin Publik:

- Takim parapërgatitor me Nëpunëset/Nëpunësit e Barazisë Gjinore në nivel qendror e vendor mbi rekomandimet nga vlerësimi i strategjisë së mëparshme dhe diskutimi mbi qëllimet kryesore strategjike të Planit, në qershor 2022.
- Takim parapërgatitor me Organizatën jo Fitimprurëse “Shoqata “Gruaja, Paqja dhe Siguria””, me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe studiues akademikë në datë 17.07.2022.
- Takim konsultues me GNP dhe shoqërinë civile mbi përzgjedhjen e qëllimeve strategjike dhe objektivave specifike të Planit të Veprimit, datë 21.03.2023.
- Konsultim i hapur me publikun përmes platformës së Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

4. Palët e interesit të përfshira

Ministritë e linjës, (7) Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (Nëpunëset/nëpunësit e Barazisë Gjinore dhe Koordinatorët/koordinatorët Vendorë kundër Dhunës në Familje) (61) , Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit Shqiptar,(1) Instituti i Statistikave Zyrtare (1).

Përfaqësues të ftuar në takimet e konsultimit parapërgatitore ishin institucione qendrore dhe vendore, institucione të pavarura dhe organizata të shoqërisë civile. (2 institucione të pavarura, Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, , 6 OJF, 5 Organizata ndërkombetare, UN-Women, OSBE, Ambasada Amerikane, Ambasada Hollandeze, SIDA).

Të angazhuara në mbështetje të gjithë punës së GNP-së për hartimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan, paqen dhe sigurinë”, 2023–2027, ishin 1 ekspert për çështjet e barazisë gjinore, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, dhe 1 ekspert i statistikave gjinore e treguesve gjinorë, kostimit dhe buxhetimit të përgjithshëm gjinor, të cilat u mundësuan përmes mbështetjes së UN Women.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Numri i shikimeve në RENJKP për këtë projektakt është 422 klikime/shikime dhe 0 komente.

Komentet dhe sugjerimet e marra gjatë takimeve, edhe më pas me shkrim nga institucione qendrore dhe vendore, organizata të shoqërisë civile si dhe nga organizata ndërkombëtare, janë pranuar dhe reflektuar në draft dokument krejtësisht, me përjashtim të sugjerimit për ngritjen e një shoqate për gratë ushtarake.

MSHMS-ja ka bashkërenduar dhe ka reflektuar të gjitha mendimet e ardhura nga ministritë e linjës duke përgatitur relacionin përfundimtar të projektvendimit për miratim në Këshillin e Ministrave.

Çështja adresuar	Komenti.	Palët interesuara	Vendimi (i pranuar/i pranuar pjesërisht/i refuzuar)	Justifikimi
Rëndësia e Kostimit të dokumentit	Të kostohej dhe buxhetohet sipas	Z. Robert Gajda, Komisioneri për	Pranuar	Është pasqyruar në dokument.

	fushave specifike te mbulimit	Mbrojtjen nga Diskriminimi		
Rëndësia e ndërvperimit me Planin e BE-së	Të bëhet ndërveprimi i planit të rezolutës me detyrimet e parashikuara në Strategjinë e BE për barazinë Gjinore.	Përfaqësuesja e OSBE	Pranuar	Pasqyruar në dokument.
Ekzistojnë raste të ngacmimit seksual në vendin e punës	Të zhvillohen trajnime të dedikuara për përballimin e situatave të diskriminit e sidomos ngacmimit seksual të çdo lloj natyre.	Zj Ines leskaj Koalicioni Gruaja, Paqja, Siguria	Pranuar	Pasqyruar në dokument.
Ngritja e një shoqate për gratë ushtarake	Të mundësohet ngritja e nje shoqatë të grave ushtarake në vijim të Planit të Veprimit për Rezolutën 1325.	Shoqata “Gruaja, Paqja dhe Siguria” zj B.C.	Refuzuar	Ngritja e shoqatës së tillë nuk është e mundur sipas legjislacionit ekzistues.